



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/217  
Datë: 16.08.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 48 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenit 23 të Rregullores Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 05/2024, në pajtim me nenin 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 gusht 2024, merr këtë:

V E N D I M

- Emërohet Komisioni Ad Hoc për Vlerësim Profesional për Pranim për pozitën e Kategorisë së Lartë Drejtuese: "Drejtor Ekzekutiv në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës, në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve në këtë përbërje:
  - Artan Ahmeti, U. D. Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, kryesues;
  - Anita Kalanderi, Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Drejtësisë, anëtare;
  - Zef Dedaj, U. D. Drejtor i Përgjithshëm, KIESA, anëtar;
  - Kaltrina Dauti, U.D. Udhëheqëse e Divizionit të Burimeve Njerëzore në MFPT, anëtare;
  - Valon Avdiu, Ekspert i Jashtëm.
- Obligohet Komisioni i lartpërmendur t'i kryej detyrat dhe përgjegjësitë e tij në pajtim me Ligjin Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe Rregulloren Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 05/2024.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë